



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:281676
Datë: 18.12.2024
Numri i dokumentit: 06620198

K.Dh.Sh.II.nr.2185/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit Company Murseli Sh.p.k, me NUI 810306010, me seli në fshatin Doganaj, Kaçanik, të cilin e përfaqëson Rexhep Murseli, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë Rr.”Migjeni” (ish banka e Lubjanës), me bazë juridike anulimin e vendimit me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.507/2024 të datës 10.10.2024 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Company Murseli Sh.p.k., me NUI 810306010, me seli në fshatin Doganaj, Kaçanik, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.507/2024 i datës 10.10.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.507/2024 i datës 10.10.2024 është refuzuar si i pabazuar propozimi i paditësit Company Murseli Sh.p.k., me NUI 810306010, me seli në fshatin Doganaj, Kaçanik, kundër të Paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me numër 2024/0675 të datës 23.09.2024, ti ndalohet ekzekutimi i vendimit dhe të detyrohet i padituri të merr masa për ndalimin e ekzekutimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e propozuesit ashtu që të prishet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KA.nr.507/2024 i datës 10.10.2024 ashtu që çështja të kthehet në rivendosje.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 13 par. 6 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe Nenit 194 të LPK-së, dhe gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Company Murseli Sh.p.k., me NUI 810306010, me seli në fshatin Doganaj, Kaçanik, pranë kësaj gjykate kanë iniciuar konflikt administrativë me kërkesë për anulimin e vendimit 2024/0675 të datës 23.09.2024, i nxjerr nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të lartcekur, ti ndalohet ekzekutimi i vendimit dhe të detyrohet i padituri të merr masa për ndalimin e ekzekutimit, deri në vendimin përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë. Paditësi, në kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e cila është pjesë përbërëse e padisë, e ka trajtuar ligjshmërinë e aktit administrativ të goditur, ndërsa nuk e ka ngritur asnjë pretendim lidhur me kushtet e nenit 22 para. 2 dhe 6 të LKA-së, por thjeshtë ka kërkuar të ndalohet ekzekutimi i aktit të goditur duke pretenduar se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 22 par.2 përkatësisht nenin 22.6 të LKA-së, me arsyetimin se me veprim të kundërligjshëm të autoritetit kontraktues e ka dëmtuar buxhetin e shtetit për 30 mijë euro duke e shpërblyer me kontratë OE i cili ka qenë me çmim më të shtrenjtë se paditësi në vlerë prej 30 mijë euro dhe se shtyrje e ekzekutimit të këtij vendimi është pro interesit publik.

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ i Gjykatës Komerciale me aktvendimin e atakuar KA.nr.507/24 të datës 10.10.2024 e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit Company Murseli Sh.p.k., me NUI 810306010, me seli në fshatin Doganaj, Kaçanik, kundër të Paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me numër 2024/0675 të datës 23.09.2024, ti ndalohet ekzekutimi i vendimit dhe të detyrohet i padituri të merr masa për ndalimin e ekzekutimit.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se Gjykata në këtë fazë të procedurës nuk mund të lëshohet në vlerësimin e pretendimeve që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e aktit administrativ, të cilat Paditësi i ka paraqitur në padi, dhe mbi këtë e ka bazuar kërkesën për shtyrjen e aktit administrativ të njëjtat nuk paraqesin bazë nga neni 22 i LKA-së për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, ndërsa lidhur me pretendimet tjera të paraqitura në padi, gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë referuar pretendimeve ankimore vlerëson se Gjykata e shkallës së parë në arsyet e vendimit me të drejtë nuk ka mundur të lëshohet në vlerësimet meritore të çështjes lidhur me raportin e ekspertit dhe as zhvillimin e procedurës së brendshme

administrative. Së këndejmi, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozuesit- paditësit, në ankesë, të cekura më lartë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe sipas vlerësimit të Kolegjit nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Sa i përket, pretendimeve ankimore rreth ri-vlerësimit të procesit pranë të paditurës, kjo Gjykatë sqaron se çështja e vendimmarrjes në organin administrativ dhe as vlerësimi i çështjes së nxjerrjes së vendimit apo ligjshmërisë së tij nuk mund të vlerësohet dhe as të ekzaminohet në këtë fazë të procedurës me rastin e shqyrtimit të shtyrjes së ekzekutimit. Kjo procedurë ndërlidhet vetëm me kushtet ligjore nga Neni 22 par.2 i LKA-së kushte këto të cilat nuk plotësohen në rastin konkret.

Dhomat e Shkallës së Dytë vijnë në përfundim se kushti ligjor për shtyrjen e ekzekutimit për shkak të interesit publik tani për tani nuk mund të vijë në shprehje bazuar vetëm në pretendimet e paditësit. Përkitazi me këtë, pala paditëse gëzon të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit për të gjitha dëmet e pretenduara nëse gjykata me rastin e shqyrtimit të padisë në merita vlerëson se akti i atakuar administrativ ka qenë i kundërligjshëm.

Andaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura, dhe se nuk i ka konstatuar drejt gjendjen faktike, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka ardhur deri te konstatimi se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të kontestohet zbatimi i vendimit nën kushtet ligjore të cilat janë të nevojshme për shtyrje të ekzekutimit të vendimit administrativ, përfshirë këtu edhe dëmin e pariparueshëm i cili nuk është dëshmuar bazuar në shkresat e lëndës.

Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për

faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.2185/2024, me datë 18.12.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova